

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

19.05.2022  
Ora 11:07

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lushnje, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë zonjën Vojsava Klement Bushi”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. M.Koja, Znj. P.Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi në rendin e ditës këto çështje:

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lushnjë”;

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pogradec”;

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Këlcyrë”;


Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë”;

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Klos”;

Kemi, për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin e denoncimit të subjektit zgjedhor Partia Demokratike, ndaj Bashkisë Rrogozhinë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”;

Kemi për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj Autoritetit Portual Durrës, Kryetarit të Bashkisë Durrës, Univeristetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”;

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

Shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kryetares së Bashkisë Lushnje, Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, drejtorit të Spitalit”;


Shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj Bashkisë Shkodër, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”;

Më pas kemi “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kandidatit për Kryetar Bashkie Rrogzhinë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe deputetit të Partisë Socialiste zotit Etjen Xhafaj”;

Pika e fundit e 11, “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj Kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrës Vendore Arsimore Rrogzhinë dhe Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla””. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaç:** Këshilli i Bashkisë Lushnjë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltaria, Enkelejda Rrapi Puka, propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 09, zonja Vojsava Klement Bushi, e cila ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 25. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka dërguar të dhënat për kandidatin për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lushnje, e cila rezulton se

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, në rubrikën e emrit nga “Vjola” në “Vojsava”. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezultoi e padënuar dhe me vendim të formës së prerë. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lushnje, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë, bazuar në nenet 19, pikat 1, të Kodit Zgjedhor si dhe Ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vendos:

1. Zonja Vojsava Klement Bushi, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lushnje, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lushnje, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, zonjën Vojsava Klement Bushi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendim nr. 161**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

19.05.2022  
Ora 11:12

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pogradec, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare, zonja Amela Arben Mimini”.*


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. M.Koja, Znj. P.Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Këshilli i Bashkisë Pogradec, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, Arben Kadri Berberi, propozuar nga Partia Aleanca Demokratike Shqiptare. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidatia me numër rendor 04, zonja Armela Arben Mimini, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 24. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka kthyer përgjigje ku rezulton se ka ndryshuar përbërësin e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

gjendjes civile, në rubrikën e mbiemrit nga “Bashalli” në “Mimini”. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka bërë verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se është “e padënuar” me vendim të formës së prerë në regjistrin penal. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Pogradec, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë, bazuar në nenet 19, pikat 1, dhe pika 2, nenin 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor si dhe Ligjin nr. 138/2015, vendos:

1. Zonja Amela Arben Mimini, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Pogradec, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pogradec, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Demokratike e Shqipërisë, zonjën Amela Arben Mimini.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendim nr. 162**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

19.05.2022  
Ora 11:14

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Këlcyrë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare, zonja Jonida Kristo Toslluku”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. M.Koja, Znj. P.Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Këshilli i Bashkisë Këlcyrë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, Kristo Rako Toslluku, propozuar nga Partia Aleanca Demokratike Shqiptare. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidatia me numër rendor 04, zonja Jonida Kristo Toslluku, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 27. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka dërguar të dhënat për kandidatin për këshilltar në Këshillin e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*


Bashkisë Këlcyrë ku rezulton se nuk ka ndryshuar përbërësit e gjendjes civile. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka bërë verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se nuk ka dënime me vendim të formës së prerë. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Këlcyrë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë, edhe për këtë rast vlerësojmë se:

1. Zonja Jonida Kristo Toslluku, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Këlcyrë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Këlcyrë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare, zonjën Jonida Kristo Toslluku.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendim nr. 163**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

19.05.2022  
Ora 11:16

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratia Sociale e Shqipërisë, zoti Kristaq Jani Vasili”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. M.Koja, Znj. P.Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Këshilli i Bashkisë Korçë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, Petraq Vangjel Premti, propozuar nga Partia Demokratia Sociale e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 03, zoti Kristaq Jani Vasili, i cila ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 26/1. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka dërguar të dhënat për kandidatin zotin Kristaq

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*


Jani Vasili i cili rezulton se ka ndryshuar përbërësit e gjendjes civile në rubrikën mbiemri, nga “Vasil” në “Vasili”. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton “i padënuar”. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Korçë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë, edhe për këtë vakancë konstatojmë se:

1. Zoti Kristaq Jani Vasili, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Korçë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratice Socialë e Shqipërisë, zotin Kristaq Jani Vasili.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendim nr. 164**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

19.05.2022  
Ora 11:18

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Klos, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Bashkim Rexhep Dardha”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Znj. M.Koja, Znj. P.Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë:** **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Këshilli i Bashkisë Klos, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, Etmond Myslim Demiri, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 07, zoti Bashkim Rexhep Dardha, i cili ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 29. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, konstatohet se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Mbështetur në pikën 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Klos, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë, edhe për këtë rast konstatohet se:

1. Zoti Bashkim Rexhep Dardha, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Klos, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Klos, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Bashkim Rexhep Dardha.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Atëherë, këto ishin të gjitha projektvendimet për plotësimin e vakancave.

**Vendim nr. 165**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

**19.05.2022  
Ora 11:20**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Partisë Demokratike ndaj Bashkisë Rrogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2. Stafi KQZ:**      **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja  
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:**
  - **KRIK**
  - **Bashkia Rrogozhinë:**      **Z. Helidon Plaku**
  - **Qëndresa Qytetare:**      **Z. R. Xhemollari, Znj. Teisa Kurti**

**Z. I. Celibashi:** Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Kemi shpalljen e vendimit, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Partisë Demokratike ndaj Bashkisë Rrogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

Përfaqësues nga Partia Demokratike nuk ka! Nga Bashkia Rrogozhinë ka përfaqësues? Po! Mirë, faleminderit!

Atëherë, në vlerësim të të gjitha pretendimeve të palëve dhe provave të administruara, çmujmë se nuk verifikohet shkelja administrative nga ana e kryetarit

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

të Bashkisë Rrogozhinë për sa pretendohet për rastin, nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike. Shqyrtimin administrativ e konsiderojmë të mbyllur pa masë administrative.

**Vendimi nr. 166**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

19.05.2022  
Ora 11:21

**RENDI I DITËS**


*Projektvendim “Për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës z. Pirro Vengu, Kryetarit të Bashkisë Durrës zj. Emiriana Sako, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit z. Klevis Hysa dhe Rektorit të Univeritetit “Aleksandër Moisiu” Durrës zj. Kseanela Sotirofski, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja  
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:**
  - **KRIK**
  - **Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, znj. Blerina Qyrana.**
  - **Organizata Qëndresa Qytetare:      Z. R. Xhemollari, Znj. Teisa Kurti**

*Z. I. Celibashi:* Atëherë, vazhdojmë me shqyrtimin e ankesës së Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës, Kryetares së Bashkisë Durrës, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit si dhe Rektorit të Univeritetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Edhe në këtë shqyrtim administrativ çmujmë se në vlerësim të të gjitha

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

pretendimeve të palëve dhe provave të administruara në seancat publike, nuk jemi para ndonjë shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Durrës. Vlerësojmë se nuk ka vend për të pranuar kërkesën dhe vendosjen e masave administrative ndaj subjekteve të denoncuara nga Organizata Qëndresa Qytetare.

**Vendimi nr. 167**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

19.05.2022  
Ora 11:22

***RENDI I DITËS***


**Projektvendim “Për shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zj. Eriselda Sefa, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Ogerta Manastirliu, Drejtorit të Spitalit “Ihsan Çabeja”, Lushnjë z. Pjerin Vogli dhe Bashkisë Lushnje”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2. Stafi KQZ:**      **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja**  
**Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:**
  - **KRIK**
  - **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Nexhila Kodra**
  - **Organizata Qëndresa Qytetare:**      **Z. R. Xhemollari, Znj. Teisa Kurti**
  - **Spitali “Ihsan Çabeja”,**      **znj. Andorna Sulo.**

**Z. I. Celibashi:** Lidhur me shqyrtimin e ankesës po të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj ndaj Kryetares së Bashkisë Lushnje, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Spitalit Lushnje, vlerësojmë pjesërisht të mbështetur pretendimin e Organizatës Qëndresa Qytetare. Për sa i përket kandidatit për kryetar të Bashkisë Lushnje, jemi para rastit të një shkelje administrative. Për sa i përket

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

veprimtarisë së ministrit, apo dhe të drejtorit të spitalit çmohet se nuk ka shkelje administrative në kuadër të veprimtarisë që ata kanë zhvilluar në ditën përkatëse. Vlerësohet se është në përputhje me përgjegjësitë e tyre institucionale. Ndërsa për rastin e kryetarit të bashkisë, vlerësohet se jemi para shkeljes administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit dhe i propozojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e sanksioneve administrative ndaj këtij subjekti.

**Vendimi nr. 168**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

19.05.2022  
Ora 11:24

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”  
ndaj Bashkisë Shkodër, për shkelje administrative në kuadër të fushatës  
zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.**


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:                                      **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja  
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:**
  - **KRIK**
  - **Organizata Qëndresa Qytetare:              Z. R. Xhemollari, Znj. Teisa Kurti**

**Z. I. Celibashi:** Në lidhje me shqyrtimin administrativ dhe shpalljen e vendimit për denoncimin e bërë po nga Organizata “Qëndresa Qytetare” ndaj Bashkisë Shkodër, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Edhe në këtë rast çmojmë se nuk jemi para shkeljeve administrative të pretenduara nga subjekti denoncues ndaj duke konsideruar dhe për këtë rast të përfunduar dhe pa rezultat hetimin administrativ, çmoj se nuk jemi para rastit për të vendosur sanksione administrative dhe nuk verifikohet ekzistenca e shkeljeve administrative. Për të gjitha këto vendime është dhe arsyetimi përkatës i cili do t’u vihet në dispozicion subjekteve të interesuara.

**Vendimi nr. 169**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

**19.05.2022  
Ora 11:25**

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kandidatit për Kryetar Bashkie Rrogozhinë z. Edison Memolla, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave z. Arben Ahmetaj, Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Etjen Xhafaj dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2. Stafit KQZ: **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja  
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:**
  - **KRIK**
  - **Bashkia Rrogozhinë: Z. Helidon Plaku**
  - **Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave:  
Znj. Salora Llatja**
  - **Qëndresa Qytetare: Z. R. Xhemollari, Znj. Teisa Kurti**

**Z. I. Celibashi:** Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Kemi shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kandidatit për Kryetar Bashkie Rrogozhinë z. Edison Memolla, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave z. Arben Ahmetaj, Deputetit të Kuvendit të Republikës

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

së Shqipërisë z. Etjen Xhafaj si dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Përfaqësues e Qëndresës janë prezent! Nga Bashkia Rrogozhinë? Po! Ju lutem mund të prezantoheni!

**Z. H. Plaku:** Helidon Plaku, Drejtor Juridik i Bashkisë Rrogozhinë.

**Z. I. Celibashi:** Nga Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave?

**Znj. S. Llatja:** Përshëndetje, Salora Llatja këshilltare politike e Zv. Kryeministrit dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, ju faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Keni autorizim?

**Znj. S. Llatja:** Po!


**Z. I. Celibashi:** Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Përfaqësuesi i deputetit nuk është prezent?! Ka marrë njoftim besoj?!

**Znj. S. Llatja:** Është në parlament dhe nuk pati mundësi të ishte prezent!

**Z. I. Celibashi:** Dakord, faleminderit! Hapim shqyrtimin administrativ të kësaj çështjeje. I japim fjalën përfaqësuesit të Qëndresës për të prezantuar pretendimet e tyre në lidhje me këto subjekte, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

**Znj. T. Kurti:** Faleminderit i nderuar! Në këtë denoncim Qëndresa Qytetare, raporton takimin e datës 4 mars 2022 të kandidatit të Partisë Socialiste të Shqipërisë për kryetar bashkie zotit Edison Memolla, ministrit për rindërtimin, zotit Ahmetaj dhe deputetit zotit Etjen Xhafaj. Në këtë takim siç shihet dhe nga faktet e përcjella para Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pjesëmarrësit gjatë këtij takimi inspektuan Shkollën “Qamil Gjuzi”, që është në proces rindërtimi. Sikurse vihet re dhe nga provat, janë promovuar investime vendore në atë zonë duke mbështetur dhe promovuar objekte të rindërtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, për sa jemi njohur me deklaratimet e palëve të përcjella në adresën tonë, në lidhje me themelin e kësaj çështjeje. Për sa i takon përdorimit ose vënies në mbështetje të kandidatëve, burime të organeve publike, pretendojmë se siç është paraqitur edhe në shkresën e Kabinetit të Zëvendës Kryeministrit dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, njihemi me faktin se zoti Ahmetaj në këtë aktivitet ka qenë pjesëmarrës në cilësinë e të ftuarit në kuadër të procesit të rindërtimit. Zoti Ahmetaj në këtë shkresë pohon se pjesëmarrja në këtë aktivitet i jep edhe cilësinë e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave. Ky aktivitet vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore. Kohë, e cila kërkon kujdes të shtuar nga ana e institucioneve publike. Në referim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, neni 91, parashikon në mënyre eksplicite se nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje, burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor. Në këtë kuptim po neni 142 i Kodit Civil, në kuptim të tij “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe çdo burim njerëzor të këtij institucioni. Po ashtu, në referim të Nenit 6, pika 3 të Vendimit nr. 9 date 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, “...Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin, veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje”. Në këtë rast, zoti Ahmetaj, në cilësinë e Ministrit, si një nga organet e larta të administratës shtetërore, ka marrë pjesë në një aktivitet, veprimtari me karakter publik, në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore. Rrjedhimisht, prezenca e ministrit favorizon kandidatin në zgjedhje, duke shtuar këtu se për këtë aktivitet mund të jenë përdorur edhe asete të tjera publike, si psh makinat e administratës së ministrit. Po ashtu jemi njoftuar me anë të shkresës Nr. 296/2 Prot. datë 01.02.2022 të Bashkisë Rrogozhinë. Theksojmë se Qëndresa Qytetare i referohet vetëm fakteve publike dhe nga kërkimet e bëra në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së, nuk rezulton të jetë raportuar ky aktivitet, duke mosrespektuar parashikimet e nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Në konkluzion pasi jemi njohur me cilësinë e palëve pjesëmarrëse në aktivitet dhe fakteve në lidhje me këtë aktivitet, palët nuk kanë respektuar parashikimet e nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Për sa më sipër, kërkojmë: Konstatimin e shkeljeve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe marrjen e masave administrative, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Fjalën ia japim përfaqësuesit të Bashkisë Rrogozhinë!

**Z. H. Plaku:** Përfaqësuesia e organizatës, ne nuk jemi dakord sepse, për sa i përket veprimtarisë së bashkisë, ka qenë gjithmonë konform rregullave. Për sa i përket investimit në fjalë, ky është një investim i datës 30.06.2021, që është 9 muaj para zgjedhjeve. Ndërsa për inspektimin që është bërë në terren, ne kemi raportuar pranë Komisionerit me shkresën nr. 296/2, dt.01.02.2022, të gjitha objektet që këtu kemi një listë me numër rendor 25 dhe mund të inspektohen gjatë programit të punës. Kështu që nuk qëndron se kjo është bërë për fushatë, por në vazhden e fushatës së punës. Është bërë që në datën 1.02 programi se ku do të shkohet për inspektime dhe

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

veprimtari të ndryshme që kanë të bëjnë kryesisht me punën e përditëshme të bashkisë. Edhe në kërkesat që ne i kemi dërguar Komisionerit, informacioni ka qenë i saktë, i plotë dhe referuar ligjeve në fuqi. Mendojmë që pretendimet e tyre nuk qëndrojnë në rastin në fjalë. Nuk e di çfarë ka zonja për pjesën...

**Z. I. Celibashi:** Do të na e thotë zonja! Kaq kishit, nuk keni gjë tjetër?

**Z. H. Plaku:** Jo!

**Z. I. Celibashi:** Mirë faleminderit! Përfaqësuesi i ...

**Znj. S. Llatja:** Atëherë në lidhje me çështjen, zoti Ahmetaj, zv. Kryeministri dhe Ministri i Shtetit për Rindërtim dhe Reformat ka qenë në cilësinë e të ftuarit, për një program që ka rreth dy vite që zhvillohet, që është programi i rindërtimit. Shkolla në fjalë që është Shkolla "Qamil Gjuzi" që është në Bashkinë e Rrogzhinës, nuk ka pas një proces financiar katër muaj, ashtu siç e citon dhe Kodi Zgjedhor, para datës së zgjedhjeve, por shumë muaj më përpara. Nuk e di në çfarë bazoheni ju për pjesën e përdorimit të makinave të institucionit. Do të doja që në lidhje me zv.kryeministrin të kemi prova dhe fakte që janë përdorur makinat e institucioneve për këtë rast, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit! Atëherë, meqenëse deputeti Etjen Xhafaj, ose përfaqësuesi i tij nuk janë prezent, kemi ndonjë gjë tjetër për të shtuar me sa keni pretenduar?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

**Znj. T. Kurti:** Për sa i përket replikës së zonjës, për aq sa zoti Ahmetaj ka qenë i ftuar në cilësinë e ministrit, është rrjedhimisht e logjikshme që ministri nuk ka shkuar me transport publik, por ka shkuar me makinat që shoqërojnë ministrat në të tilla aktivitete. Dua të shtoj këtu edhe faktin që gjatë asaj dite nuk është bërë vetëm ky takim i zotit Ahmetaj me zotin Memolla, por janë bërë dhe disa takime të tjera elektorale të cilat janë të pasqyruara në profilet e tyre zyrtare, por ky ishte rasti flagrant i përdorimit të cilësisë së tij si Ministër i Rindërtimit për promovimin e rindërtimit të shkollës në fjalë.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Keni diçka për të shtuar?


**Znj. S. Llatja:** Në lidhje me takime të tjera elektorale të cilat janë të pasqyruara, kanë qenë në kuadrin e të qenurit një ish deputet i asaj zone, i ftuar nga subjekte të tjera. Në lidhje me pjesën e promovimit të shkollës, në dijeninë time, duke qenë se kam ndjekur të gjithë pjesën e komunikimeve që janë bërë dhe në media, në asnjë moment, zoti Ahmetaj nuk ka bërë pjesën e promovimit as të kandidatit, por promovimin e një pune të bërë nga Ministri i Shtetit për Rindërtim dhe Reforma, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi i bashkisë, ka diçka tjetër për të shtuar? Jo! Keni kërkesë për administrim të dokumentacionit, apo marrjen e dokumentacionit që ju mendoni që është i lidhur me pretendimet tuaja?

**Znj. T. Kurti:** Jo!

**Z. I. Celibashi:** Nuk keni! Nga ana e Bashkisë Rrogzhinë, ose përfaqësuesit të Zv. Kryeministrit dhe Ministrit të Shtetit? Nuk kemi! Atëherë, e konsiderojmë të mbyllur

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

hetimin administrativ. Fjala e fundit për përfaqësuesit e Organizatës Qëndresa Qytetare dhe më tej për përfaqësuesit e Bashkisë Rrogozhinë dhe të Zv. Kryeministrit dhe Ministrit të Shtetit. Përfundimisht!

**Znj. T. Kurti:** Përfundimisht, për sa thamë në këtë seancë, ne i qëndrojmë kërkimeve tona dhe kërkojmë marrjen e masave administrative për palët e denoncuar.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi i bashkisë, përfundimisht!

**Z. H. Plaku:** Kërkojmë rrëzimin e pretendimeve të organizatës në fjalë, sepse çdo veprimtari që është bërë nga bashkia, ose kandidati në këtë rast, ka qenë konform ligjit, e deklaruar më parë. Jemi në zbatim të Kodit Zgjedhor!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Po përfaqësuesja e zv. Kryeministrit dhe Ministrit të Shtetit!

**Znj. S. Llatja:** Gjithashtu dhe ne jemi në kërkim të rrëzimit të vendimit që kërkon Organizata Qëndresa Qytetare në këtë rast, duke qenë se kemi qenë në cilësinë e të ftuarit. Kemi qenë konform të gjithë rregullave. Kemi qenë pjesë e deklarimeve të cilat janë bërë qoftë nga Bashkia Rrogozhinë, por gjithashtu nga Instuticioni i Kryeministrit, duke qenë se është i atashuar pranë Instuticionit të kryeministrit, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! E mbyllim shqyrtimin administrativ dhe shpalljen e vendimit do ta bëjmë në një seancë tjetër e cila do t'u njoftohet zyrtarisht data dhe ora, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

19.05.2022  
Ora 11:39

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, zotit Edison Memolla, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrës Vendore Arsimore Rrogozhinë dhe Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja  
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë:**
  - **KRIK**
  - **Bashkia Rrogozhinë:      Z. Helidon Plaku**
  - **Qëndresa Qytetare:      Z. R. Xhemollari, Znj. Teisa Kurti**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit të organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës dhe Zyrës Vendore Arsimore Rrogozhinë si dhe Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Përfaqësuesit e Qëndresës janë prezentë, përfaqësuesi i Bashkisë Rrogozhinë është prezent, Drejtoria Rajonale Arsimore Durrës nuk ka përfaqësues, Zyra Vendore Arsimore Rrogozhinë, Qendra Kulturore “Haxhi Memolla”? Nuk ka!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

Dakord! Mirë, atëherë hapim shqyrtimin administrativ dhe hetimin administrativ në lidhje me këtë denoncim. I japim fjalën përfaqësuesit të organizatës Qëndresa Qytetare për të prezantuar pretendimet në lidhje me këto shkelje.

**Znj. T. Kurti:** Përsa u përket rrethanave të faktit të këtij denoncimi, në datën 16 shkurt 2022 është bërë inaugurimi i Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, nga kryetari i Bashkisë Rrogozhinë në detyrë, zoti Edison Memolla, i cili gjithashtu ishte dhe kandidat për këtë bashki, i subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë. Inaugurimi i këtij objekti kulturor vjen vetëm tri ditë para çeljes së fushatës zgjedhore dhe ky aktivitet nuk rezulton të jetë i njoftuar më parë, në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përsa u përket fakteve dhe përgjigjeve që janë paraqitur nga palët e denoncuara, jemi njohur me faktet se nga Bashkia Rrogozhinë me shkresën kthim-përgjigje është bërë me dije se në datën 16 pranohet të jetë bërë inaugurimi i qendrës kulturore “Haxhi Memolla” nga kryetari i bashkisë. Inaugurimi i këtij objekti kulturor, siç e thamë vjen vetëm tri ditë para çeljes së fushatës zgjedhore dhe është kryer nga kandidati për kryetar i kësaj bashkie. Rrjedhimisht promovimi dhe inaugurimi i këtij objekti kulturor në një kohë që përkon me periudhën zgjedhore implikon favorizimin e kandidatit në zgjedhje duke vënë në mbështetje të tij burime të organeve apo enteve publike, duke përfshirë kështu edhe asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, siç parashikon dhe neni 142 i Kodit Civil. Ne me shkresën e Zyrës Arsimore Rrogozhinë informohemi se në këtë aktivitet kanë qenë gjithashtu edhe pjesëmarrës, nxënësit e grupit artistik të shkollës “Haxhi Qehajaj” dhe grupit artistik të kopshtit Rrogozhinë. Kujtojmë se orari i zhvillimit të këtij aktiviteti merr karakter publik, sipas raportimeve dhe pohimeve të bëra nga përgjigjet e institucioneve, është ora 11, e cila përkon me orarin mësimor. Pra, nxënësit në një kohë që duhet të ishin në klasat e mësimi, janë në një aktivitet


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

inaugurimi me kandidatin për kryetar bashkie. Së treti, në referim të shkresës së Zyrës Arsimore Rrogozhinë, informohemi shprehimisht se inaugurimi paraparak i kësaj qendre kulturore është bërë më datën 16 shkurt, për arsye sepse subjektet politike kanë kërkuar zhvillime të takimeve të hapjes së fushatës elektorale në këtë qendër. Në këtë mënyrë i gjithë diskursi i këtij denoncimi është ndryshuar nga pohimi i këtij institucioni, i cili pranon se një burim publik në administrim të Bashkisë Rrogozhinë, në këtë qendër është kërkuar të zhvillohen takime elektorale, për këtë arsye është bërë një inaugurim i përshpejtuar. Në referim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, neni 91 që parashikon në mënyrë eksplicite se nuk mund të përdoren, ose të vihen në mbështetje të kandidatëve apo partive politike, apo koalicioneve, burimet e enteve publike, në nivel “qendror” ose “vendor”. Gjithashtu siç parashikohet edhe për asetet e luajtshme dhe të paluajtshme. Në konkluzion ne besojmë se pasi jemi njohur me rrethanat dhe faktet mbi këtë aktivitet, gjithashtu jemi njohur edhe me deklarimin abuziv të Zyrës Vendore Arsimore Rrogozhinë për inaugurimin e parakohshëm për arsye të zhvillimeve elektorale, do të donim të kërkonim një informacion më të hollësishëm nga ana e këtyre institucioneve mbi këtë deklaram. Nëse ky inaugurim është bërë në një mënyrë të parakohshme për aktivitete elektorale, do të donim të dinim nëse ka pasur aktivitete të tjera elektorale që janë kryer në këtë burim publik, nën administrim të Bashkisë Rrogozhinë. Përse më sipër kërkojmë zbardhjen e mëtejshme të këtij deklarami, të bërë nga Zyra Vendore Arsimore dhe konstatimin e shkeljeve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me denoncimin me numër 3684 ID. Po ashtu marrjen e sanksioneve administrative bazuar në nenin 172 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste dhe kandidatit zotit Edison Memolla.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi i kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë!

**Z. H. Plaku:** Përsa u përket pretendimeve të organizatës në fjalë, theksoj se ky investim për rikonstruksionin e qendrës kulturore të Bashkisë Rrogozhinë ka një vit e gjysmë që ka nisur. Projekti është i përfunduar në afatin e duhur sipas kontratës. Ne jemi shprehur dhe në korrespondencën, në qoftë se është e nevojshme ne e bëjmë publike dhe kontratën, jua dërgojmë në qoftë se është e nevojshme. Nuk ka lidhje fare me fillimin e fushatës, por ka qenë program i tillë që mbaroi dhe do të inaugurohej. Është e deklaruar në faqen e Komisionit një nga aktivitetet dhe financimi nuk është i qeverisë shqiptare, por është i një fondacioni zviceran që në kuadrin e programit të zhvillimit rajonal në Shqipëri ka investuar në ish kinemanë e qytetit, siç ka bërë dhe në qytete të tjera. Nuk ka të bëjë fare me pjesën e financimit nga qeveria për efekt elektoral, sepse marrëveshja është lidhur më 27.11.2020. Pastaj deri sa janë bërë procedurat dhe kanë përfunduar punimet që duan kohën e vet, kemi arritur në këtë, të gjitha këto janë të deklaruara. Sa i përket marrjes me qira nga subjektet politike që garonin në zgjedhjet e pjeshme, po kanë marrë, si “Shtëpia e Lirisë”, si Partia Demokratike, kanë bërë kërkesë dhe u është ofruar pallati për të bërë aktivitete, Partisë Socialiste, kush ka dashur e ka marrë. Nuk është se është penguar ndonjë subjekt që do e bëjë Partia Socialiste, nuk do e bëjë “Shtëpia e Lirisë”, apo Partia Demokratike. Siç funksionon rëndom në Shqipëri pallatet e kulturës në fushata janë përdorur duke iu dhënë me qira subjekteve politike për aktivitetet e tyre. Data 16 që është bërë dhe marrja pjesë e shkollave nuk është e vërtetë. Aty kanë qenë dy grupe fëmijësh me kostume popullore, grupe baleti, nuk është se ishin shkollat aty. Këto ishin thjesht për zbukurimin e festës, grupet e fëmijëve, siç e kanë thënë dhe këta të zyrës arsimore. Kështu që të gjitha këto

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

pretendime që u parashtruan më lart për mendimin tonë nuk qëndrojnë, sepse edhe korrespondenca e sqaron qartë kur kanë filluar procedurat, kur kanë mbaruar dhe pjesën e përdorimit kush ka dashur ta marrë me qira, e ka marrë, nuk është që ka favorizim të një subjekti apo të një tjetri. Kështu që pretendimet sipas nesh nuk qëndrojnë.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e organizatës!

**Znj. T. Kurti:** Një ndërhyrje. Domethënë përtej përdorimit të asetit, unë dua të citoj statusin e kandidatit për kryetar, zotit Memolla për këtë rast, që thotë “Ditën e sotme i paraprijmë inaugurimit të godinës së re, të qendrës kulturore në mënyrën më të bukur. Pasi të kalojmë fazën e zgjedhjeve lokale do të pritët shiriti simbolik për hapjen e qendrës. Falenderoj të gjithë ata që kontribuan për realizimin e këtij projekti! Falenderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe nxënësit për aktivitetin e këndshëm me këngë, valle, recitime të realizuara”. Pra, vetë kandidati për kryetar bashkie thotë “falenderoj nxënësit” në orën 11 të ditës “falenderoj nxënësit për aktivitetin e këndshëm” që i kanë ofruar këtij aktiviteti parainaugurues, mund ta quajmë, pasi nuk ishte inaugurimi përfundimtar i kësaj. Në këtë kuptim, pra përtej përdorimit të asetit dhe debatin mbi asetin, ne si organizatë e kemi shumë të rëndësishme përdorimin e shkollave dhe të nxënësve dhe marrjen e tyre në aktivitete të tilla, apo përdorimin e tyre në aktivitete të tilla. Nuk mund të themi që ata fëmijë aty nuk kanë qenë nxënës, apo ata fëmijë aty, s’ka gjë se atë ditë nuk kanë bërë shkollë. Kodi Elektoral dhe Legjislacioni në fuqi është goxha i rreptë për sa i përket përdorimit të aseteve dhe në këtë kuptim Drejtoria Arsimore Durrës nuk ka dhënë asnjë shpjegim dhe asnjë përgjigje për këtë çështje, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Po, kishit diçka për të shtuar?

**Z. H. Plaku:** Jo, thjesht e citoi dhe vetë që “na kënaqën fëmijët me këngët dhe vallet”, me një fjalë ishin grupe artistike të fëmijëve, nuk ishin nxënës që kishin ardhur që të bënin tifoza.

**Znj. T. Kurti:** Nëse mundem! Nga vetë zyra arsimore specifikohet konkretisht që janë nxënës të shkollës dhe të kopshtit. Nga vetë zyra arsimore pranohet që janë nxënës të shkollës dhe kopshtit.

**Z. I. Celibashi:** E fundit për ju në lidhje me këtë dhe vazhdojmë.

**Z. H. Plaku:** Jo, kjo kuptohet që ata nxënës shkolle do të jenë, sepse çdo shkollë ka grupet e veta arsimore për valle, për këngë, për sport, kështu që ata nxënës shkolle do të jenë, por nuk është se ishin pesëqind nxënës, aty ishin dhjetë fëmijë që kërcenin në këtë aktivitet, për ta zbuluar.

**Z. I. Celibashi:** Keni pamje të aktivitetit ju?


**Z. H. Plaku:** Normal duhet të ketë, në rrjetet sociale duhet të jenë.

**Znj. T. Kurti:** Ne i kemi depozituar pamjet nga denoncimi ynë!

**Z. I. Celibashi:** Ju keni, i dispononi pamjet?

**Z. H. Plaku:** Po, normal!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

**Z. I. Celibashi:** Në rregull, faleminderit! Në lidhje me dokumentacionin, apo prova që kërkoni të administrohen në këtë shqyrtim, përfaqësuesit e Qëndresës? Veçmas atyre që keni depozituar bashkëlidhur denoncimit, të tjera, informacione, sqarime, dokumente nga institucionet, kërkoni gjë tjetër?

**Znj. T. Kurti:** Për këtë rast siç kemi paraqitur edhe në prapësimet tona do të donim një hetim apo informacion më të thelluar nga ana e zyrës arsimore, përsa i përket deklaramit për një inaugurim të parakohshëm për takime elektorale dhe po ashtu do të donim pse jo, që dhe Drejtoria Vendore Arsimore Durrës të përgjigjej për këtë rast ku me një burim publik, në një aset publik, kandidati për kryetar bashkie po mban një takim me nxënësit e shkollës.


**Z. I. Celibashi:** Në rregull! Domethënë ju kërkoni një informacion sqarues nga ana e Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës për këtë, kjo është? Dakord! Mirë, ju keni ndonjë kërkesë?

**Z. H. Plaku:** Jo, do të bëja një saktësim. Në qoftë se do të kërkohet është Zyra Vendore Rrogozhinë pastaj, sepse kështu janë të organizuara. Drejtoria është në Durrës, ka zyra vendore...

**Z. I. Celibashi:** Po! Kam përshtypjen që e kanë të qartë dallimin, por e kërkojnë informacionin nga Drejtoria Rajonale Arsimore Durrës.

**Znj. T. Kurti:** Po! Gjithashtu pyetja ime do të ishte, kush është institucioni përgjegjës për administrimin e qendrës kulturore?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt 19.05.2022*

**Z. H. Plaku:** Bashkia Rrogozhinë.

**Znj. T. Kurti:** Po ashtu informacion nga Bashkia Rrogozhinë nëse janë ndërmarrë takime të tjera në këtë qendër kulturore.

**Z. H. Plaku:** E deklarova që janë marrë. Kanë kërkuar subjektet.

**Znj. T. Kurti:** Mund të na sillni një informacion zyrtar?

**Z. H. Plaku:** Normal!

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Atëherë do t'i kërkojmë Bashkisë Rrogozhinë një informacion në lidhje me administrimin dhe aktivitetet e kryera në qendrën kulturore. Gjithsesi edhe Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, nëse kanë informacion në lidhje me këtë, por unë mendoj që do të vrente dhe për Zyrën Vendore Arsimore Rrogozhinë. E fundit, një kopje të kontratës për ndërtimin a rikonstruksionin e këtij objekti, është rikonstruksion se ka qenë kinema thatë dhe është bërë qendër kulturore. Dakord? Kemi kërkesa të tjera? Nuk kemi! Mirë, faleminderit! Mbyllet seanca për këtë çështje. Tjetër çështje nuk kemi në rendin e ditës, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

